

STUDIME

Dr. Feti Mehdiu, Fakulteti i Filologjisë - Prishtinë

NË VIGJILJE TË KATËRDHJETVJETORIT TË ORIENTALISTIKËS SHQIPTARE

Në vitin 2013 bie një jubile i cili për shkencën dhe kulturën shqiptare, sado që aktualisht nuk jehon ashtu si e meriton, ka rëndësi shumë të madhe. Rëndësia më e madhe e këtij jubileu qëndron në faktin se historia e popullit shqiptarë nuk mund të shkruhet, apo të shkruhet e të qëndrojë, jo vetëm 20-30 vjet por të bëjë ballë kohërave që vijnë, pa u mbështetur në burimet e atij shteti nën sundimin e të cilit shqiptarët jo vetëm që i kaluan rreth pesëqind vjet, por ata morën pjesë aktive në krijimin e historisë së asaj periudhe aq të gjatë. Shqiptarët, gjatë asaj periudhe, nën ombrellën e shtetit Osman arritën të kenë një shtet të quajtur Arnautluk (Shqipëri) e cila përbëhej prej katër njësive shtetërore dhe kishte 60.000 km², sipas Sami Frashërit¹, ndërsa sipas burimeve austriake² i kishte 88.854 km².

Burimet historike për shqiptarët – për këtë periudhë – gjenden, në radhë të parë, në arkivat dhe bibliotekat e Stambollit dhe të Ankaras.

Kuadrot profesionale-shkencore që do të kryenin këtë punë shumë të vlefshme për historinë e shqiptarëve sot, të vetmin institucion ku përgatiten nga aspekti hulumtues-shkencorë në mënyrë të duhur është katedra e studimeve orientale në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Kjo katedër, në vitin 2013 mbush katërdhjet vjet të veprimtarisë së vet.

Jubileu i katërdhjetëvjetorit meriton të shënohet jo vetëm sa për të thënë, por duhet bërë një qasje me një analizë kritike për hapat që i ka bërë gjatë këtyre katërdhjetë vjetëve. Është e nevojshme t'i hidhet një sy rropatjeve e peripecive që ka përjetuar edhe kjo katedër, sikur që ka përjetuar i tërë arsimi shqip në Kosovë.

¹ Te Samiu është gabimisht: “6 qind mij km”

² Eqrem Zenelaj. Çështja shqiptare nga këndvështrimi i diplomacies dhe gjeostrategjisë së Austro-Hungaris (1699-1918), Prishtinë, 2010.

Njëloj duhet vepruar edhe me rezultatet që ka arrijt në këtë moshë të sajë. Për këtë moshë mund të thuhet se është moshë e rritjes dhe formimit, prej cilës tek pas formimit e pjekurisë duhet prituri frytet e mirëfillta shkencore.

Hapat e parë

Të gjitha punët në fillim përcillen me vështirësi të caktuara, kurse më vonë, është normale që ato vështirësi të tejkalohen, ose ndodh që vazhdimisht të përcillen me peripeci të ndryshme. Degës së orientalistikës i ka rënë hise më shumë nga kjo e dyta se sa nga e para.

Kishin kaluar vetëm tre vjet nga themelimi i Universitetit të Prishtinës dhe trembëdhjet vjet nga fillimi i punës së Fakultetit Filozofik në Prishtinë kur u themelua Dega e Orientalistikës në gjiun e këtij Fakulteti. Kjo ishte në vitin akademik 1973/74.

Në Prishtinë, në Shkollën e lartë pedagogjike kishte vepruar, deri në këtë kohë, katedra për studjimin e gjuhës dhe letërsisë turke për nevoja të minoritetit turk në Kosovë, ku studjonin, kryesisht minoriteti turk për nevoja arsimore e kulturore të këtij minoriteti.

Me zhvillimin e Universitetit të Prishtinës katedra e gjuhës turke duhej të kalonte në Fakultetin Filozofik, tani si bërthamë e cila duhej të përgatiste, krahas kuadrit për nevoja arsimore e kulturore, edhe kuadra për hulumtime shkencore, në përputhje me obligimit statutare të Fakultetit.

Në katedrën e turkologjisë në SHLP, nuk kishte kuadro me tituj shkencorë që do të plotësonin kriteret e parapara në nivelin e Fakultetit. Në Fakultetin filozofik, i vetmi kuadër me titull shkencorë e thirrje universitare nga kjo lëmi ishte prof. dr. Hasan Kaleshi. Ai asokohe jepte osmanishten dhe shkencat ndihmëse të historisë në katedrën e historisë. Prof. Hasan Kaleshi si kuadër i domosdoshëm për avansimin e turkologjisë së deriatëhershme në mënyrë që ajo të kalojë në fakultet, i vetëdijshëm për rëndësinë që ka formimi i kuadrove shkencore nga kjo fushë për nevojat hulumtuese shkencore të historisë dhe kulturës shqiptare, përdori autoritetin e vet shkencorë dhe me ndihmën e atyre që ishin të vetëdijshëm për nevojën e formimit të këtij profili shkencor, ajo katedër u ngrit në një shkallë të një Dege të re arsimore- shkencore dhe u emërtua *DEGA E ORIENTALISTIKËS*. Këtu do të përgatiten kuadra nga lëmi i turkologjisë dhe lëmia e filologjisë orientale e cila nënëkupton kuadrat që do të profilizohen edhe në arabistikë edhe në turkologji.

Pas konsultimeve përgatitore paraprahe në organet universitare e shtetërore, në dhjetor të vitit 1973 fillon mësimin gjenerata e parë e degës së Orientalistikës. Kur filloi punën Dega kishte vetëm një profesor i cili kishte marrëdhënie të përhershme pune me Fakultetin Filozofik. Ai ishte Prof. dr. Hasan Kaleshi, i cili mbante mësimet e gjuhës arabe. Për gjuhën turke, menjëherë angazhohet nga SHLP, Sebahate Mahmuti, kurse prej marsit 1974 angazhohet, asistent për gjuhën arabe, Feti Mehdiu, asokohe asistent në Entin (tani Instituti) e Historisë në Prishtinë. Më vonë u angazhuan edhe kuadra tjera dhe me këmbëngulësinë e prof. H.Kaleshit çështja e kuadrit pothuajse u stabilizua: 1 profesor, 1 ligjërues, 2 asistentë për arabistikë dhe 2 asistentë për turkologji.

Më pastaj disa u zgjodhën dhe kaluan në marrëdhënie të përhershme pune, në vitin 1974: Feti Mehdiu dhe Nimetullah Hafiz, kurse Ismail Ahmedi, Muxhait Asimov, në vitin 1976, etj. Profesor Kaleshi i orientoi kuadrat e reja për fushat përkatëse: F. Mehdiu dhe N. Hafiz për gjuhësi, kurse I. Ahmedi dhe M. Asimov për letërsi, të cilët më vonë magjistruan dhe doktoruan në këto lëmi.

Pas vdekjes së Dr. Hasan Kaleshit (korik-1976) Orientalistika humbi shtyllën kryesore, por puna vazhdoi.

Nuk kaloi shumë kohë dhe dolën në sipërfaqe disa forca me interesa të ndryshme dhe filluan angazhimet për shndërrimin e degës së orientalistikës në degë të turkologjisë, ose, të paktën, ta ndajnë në dy drejtime: *Degë e turkologjisë* dhe *Degë e arabistikës*. Nga kjo ndarje do të humbaste profili hulumtues-shkencor për studjimin e historisë dhe kulturës shqiptare. Falë perkrahjes së disa kuadrave me kredibilitet shkencorë dhe shoqëror në fakultet dhe fal rezistencës së kuadrave me vetëdije të kthjelltë kombëtare dhe formim profesional shkencorë Dega e orientalistikës vazhdoi punën ashtu siç e kishte filluar në vitin 1973.

Problemi i shthurjes së degës, me pretekstin e reformimit a të profilizimit, disa herë është inicuar dhe është vënë në diskutim në Degë, madje edhe në organet tjera të Fakultetit Filozofik, deri në vitin 1989, por nuk ka pas sukses.

Deri në vitin 1990 në Degën e orientalistikës kanë punuar arsimtarët dhe bashkëpunorët: Prof. dr.Hasan Kaleshi, Sebahate Mahmuti (ligjërues), Surejja Jusufi (ligjërues), dr. Feti Mehdiu, dr. Nimetullah Hafiz, Mr. Ismail Ahmedi, Mr. Muxhait Asimov, dr. Esad Duraković, Mr. Mehdi Polisi, dr. Irfan Morina, Mr. Shemsi Ajvazi, dr. Haris Silajxhiq, Mr. Iljaz Rexha, Ruzhdi Lata, Shemso Shaqiroviq, Suzana Dedović, Mehmet Beqović, ndërsa me status të bashkëpunorit të jashtëm kanë qenë të angazhuar, kohë pas kohe, edhe: Sulejman Brina, Nehar

Shishko, Xhelal Lajçi, dr. Rade Bozhoviq, Mr. Vojisllav Simiq, Mr. Ismet Kasumoviq, dr. Hamdi Hasan.

Lektorë për gjuhë të huaj kanë qenë: Dr. Muhamed Mufaku, (për gjuhë arabe), Shahmeran Baltaxhioglu, Idris Gyven Kaja (për gjuhë turke)

Në ndërkohë, disa nga arsimtarët e degës së orientalistikës, për arye objektive e familjare e kishin lëshuar Fakultetin Filozofik të Prishtinës, si Dr. Esad Durakoviq, Dr. Muhamed Mufaku dhe Dr. Haris Silajxhiq.

Viti 1990, me formimin e fondit “Sveti Sava” nga organet e pushtetarëve serb në Kosovë, mund të thuhet bëri diferencimin midis kuadrave arsimore dhe u bë e qartë se kush do të mbetej në fakultet, pas përzënies me dhunë të studentëve dhe personelit arsimor shqiptarë.

Deri në vitin 1990, studentët e orientalistikës nuk dalloheshin se ç’gjuhë flisnin dhe ç’feje i takonin. Këtu kanë studiuar shqiptarët, turqit, serbët, malazeztë etj, secili në gjuhën e vet amëtare. Në vitin 1991 studentët dhe arsimtarët shqiptarë u hodhën jashtë objektit, por ata nuk u gjuhëzuan. Vazhduan punën ashtu si mundën dhe si ditën me përkrahjen e popullatës shqiptare, jo vetëm në Prishtinë, por nga e tërë hapësira shqiptare.

Dega e Orientalistikës, sikur edhe të tjerat, i bëri ballë tërë peripecive e dhunës së shkaktuar nga okupatori serbosllav, dhe tani, në procesin mësimorë – jashtë objekteve universitare vazhduan: dr. Feti Mehdiu, dr. Ismail Ahmedi, dr. Mehdi Polisi, dr. Abdullah Hamiti, dr. Ilaz Rexha, dr. Isa Memishi, të cilët edhe në këtë situatë nuk e ndërprejnë punën e tyre me Degën e Orientalistikës.

Gjatë periudhës së veprimit paralel të arsimit në Kosovë, 1990-1999, janë shprehur, përsëri, tendenca për ngushtim të veprimtarisë së Degës së Orientalistikës, për shkak të rënies së numrit të studentëve. Edhe kësaj herë mbijetoi dhe ngadhnjeu ideja se Kosova ka nevojë për orientalistë, jo vetëm për turkologë e as vetëm për arabistë, sepse vetëm orientalisti mund të përgatitet të trokas në dyerët e arkivave të Stambollit e Ankarasë, që janë aq të domosdoshme për historinë shqiptare.

Rezultate

Me gjithë këto rropatje e peripeci që i përjetoi Dega e orientalistikës – krahas atyre të përgjithshmeve me të cilat u ballafaqua i tërë arsimi shqiptarë në Kosovë – këtu janë arritur rezultate të lakmueshme në përgatitjen e kuadrave hulumtuese-shkencor e arsimore-kuturore, për të cilat suksese, ma thotë mendja, se punonjësit e

kësaj Dege tash, pas katërdhjetë vjetë pune, kanë arsye të mburren dhe duhet të ecin kryet lart për shërbimin që i kanë dhënë historisë e kulturës shqiptare në përgjithësi, dhe sidomos për kontributin që kanë dhënë në afirmimin e Kosovës (në vend dhe Jashtë).³

Gjatë kësaj periudhe në Degën e Orientalistikës kanë kryer studimet rreth dyqind e pesëdhjetë studentë, që fillon nga data 3 tetor 1977, kur diplomoi studenti i parë.

Me gjithë vështirësitë që i kanë përcjellë këto gjenerata, mungesa e literaturës, mungesa e kuadrit arsimor – në vitet e para të punës, përzënia nga objektet universitare, në vitin 1990, gjë që ka kushtëzuar edhe reduktime të planprogrameve, përpjekjet e disa hershme me qëllim të dezorientimit dhe të shtrembërimit të qëllimit të themelimit të këtyre studimeve, shpeshherë me vlerësime kuturu, me pretekst kinse të plotësimit të nevojave që kërkon shoqëria kosovare - Dega e Orientalistikës, falë punës me këmbëngulësi e vetëdije të kthjelltë të kuadrave të saj, ka dijtë që për këta katër dekada të bluj me profesionalizëm drithin që i ka qit fati në mullirin e saj.

Nga gruri i klasit të parë ka dhënë miell të klasit të parë, nga ai i klasit të dytë ka dhënë miell të klasit të dytë dhe kështu nga të gjitha kategoritë e ka ushqyer opinionin shkencor në mënyrë meritore, jo vetëm opinionin shkencorë në Kosovorë, por edhe më gjërë.

Çfarë do të gatuaj shoqëria kosovare varet nga aftësia e gatishmëria për ta kuptuar rëndësinë që ka dhe nga mjeshtria e tyre se si do ta gatuajnë. Edhe nga mielli i dedikuar për petë, nëse nuk di si ta gatuash, mund të dalë një ushqim që nuk ahahet fare.

Garancë e punës me kujdes e me sukses në realizimin e programit mësimor në këtë degë janë disa fakte.

I pari, kuadrat që kanë kryer me sukses studimet në këtë Degë, sot ushtrojnë detyra me rëndësi shkencore, kulturore, informative etj. Disa prej tyre kanë arritur grada shkencore të magjistratit të shkencave dhe të doktorit të shkencave jo vetëm në Universitetin e Prishtinës por edhe në Universitete të tjera botërore si në Stamboll, Hartum, Sarajevë, Beograd, Split etj.

Nga ata që kanë arritur gradat shkencore të doktorit të shkencave janë: M. Polisi, I. Morina, A. Hamiti, B. Gërbeshi, I. Memishi, S. Canhasi; gradën e magjistratit të

³ Shih: Studime orientale 2, 2002, fq. 213; Maturantët e pare të medreses Alauddin, Prishtinë. 2007, etj.

shkencave e kanë mbrojtë: A. Xheladini, I. Demiri, H. Gjokaj, R. Lata, A. Ismaili, A. Islami, K. Shehu, J. Hondozi, N. Safqi, E. Bajmak, S. Selimi, etj., si edhe boshnjakët A. Muminoviq, H. Alibashiq, I. Osmanoviq, M. Ibrahimoviq, H. Omeroviq. Ka edhe të tjerë që kanë kryer studimet pasuniversitare dhe janë në procedurë të mbrojnë punimet e magjistraturës.

I dyti, është fakti se, një numër krejtësisht i vogël prej tyre janë të papunësuar në fahun e vet. Duhet thënë me keqardhje se, përveç një numri të vogël, të tjerët nuk kanë gjetë përkrahje për të kontribuar në fushën për të cilën janë përgatitur në këtë fakultet. Përveç në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin e Kosovës të cilat kanë pranuar nga një kuadër, institucionet e tjera, si Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Muzeu i Kosovës si edhe arkivat komunal të Kosovës, me gjithë faktin se kanë terren të pasur me lëndë të rëndësishme shkencore dhe kulturore orientale, nuk kanë paraparë asnjë vend të punës për kuadra të këtij profili.

Për faktin *e tretë* flasin kontributet e tyre shkencore e profesionale të botuara deri tash në Kosovë dhe jashtë Kosovës.⁴

Perspektiva

Më rastisi, në kohë të fundit, të lexoj një mendim të art i cili vlen edhe për gjendjen tonë në këtë fushë. Aty thuhej se në demokraci nuk të mbytet askush, mbytesh vetë. Kështu merret pjesë në vetëmbytjen e historisë të popullit shqiptarë.

Me cilindo që të bisedojsh për rëndësinë e studimeve orientale për historinë shqiptare ka për të thënë se pa ato hulumtime nuk ka histori të mirëfilltë objektive, kurse institucionalisht, edhe tash në Kosovën e lirë dhe demokratike nuk është bërë ndonjë hap konkret lidhur me hulumtimet konkrete nga kjo fushë.

Ky moskujdes ndaj kuadrave të reja nga lëmi i orientalistikës ndikon negativisht në suksesin e përgjithshëm të rinisë që përcaktohet për të studjuar në këtë fushë. Në rrethanat e reja të krijuara në Kosovë, pas luftës së Kosovës 1997-1999, respektivisht pas çlirimit të Kosovës, janë krijuar rrethana solide për realizimin e këtyre detyrave që i kemi ndaj historisë. Institucionet shkencore në Turqi po tregojnë gatishmëri të plotë për të ndihmuar në këtë drejtim, orientalistika

⁴ Rreth 50 vepra dhe 600 njësi bibliografike. Shih "Studime Orientale", nr.2, Prishtinë 2002; Feti Mehdiu. Orientalistika shqiptare në shërbim të cultures kombëtare. Fakti, dt. 24.06.2000. Shkup.

prodhon kuadra serioze për këtë qëllim, porse institucionet përkatëse të Kosovës duhet të kujdesen për specializimin e mëtejshëm të tyre sipas nevojave që ka Kosova.

Si përfundim dele se, lëndë të parë për një kosh ka plot, por koshi nuk thuret vetë. Kërkon dorë mjeshtri që ta thurë.

Si ta bëjmë ashtu do ta kemi.

FOUR DECADES OF TOILING AND OUTCOMES OF THE ALBANIAN ORIENTALISTICS

Resume

The oriental studies in the Philological Faculty in Prishtinë started in 1973/ 74 with the establishment of the Oriental Department. This academic year, 2013/4 is the 40-ieth anniversary of the activities of this Department. The founder of this Department, among other professors was PhD. Hasan Kaleshi, and I was from the beginning in the education process during all this time. During 40 years period, the department faced with a lot of problems of different sorts, starting from the financial until the risk of extinguishment. But thanks to endeavors and perseverance of the lecturers, and the support of some relevant University factors it undergoes all crisis.

By so far outcomes its worthy to emphasize that here graduated about two hundred Cadres from the entire Ex Yugoslavia space, and now Kosova, Macedonia, Montenegro, and Albania. Also the Cadre that worked here and those who were students of this Department, until now offered for the cultural and scientific audience about fifty works from the Oriental Studies subjects as: Academic texts, studies and monographs, translations from Arabic and Turkish literature. We will discuss about all of this in this occasional presentation. More in depth sources can be found in the review *Studime Orientale*, nr. 2.2002, Prishtinë.